

VENDIM
Nr.449, datë 9.7.2004

PËR FINANCIMIN E URDHRI TË FARMACISTËVE PËR NJË PERIUDHË NJËVJEÇARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 20 të ligjit nr.9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshlli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e fondit Urdhrit të Farmacistëve, në shumën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për një periudhë njëvjeçare, e cila të përdoret për:

a) shpenzime për shpërblimin e drejtuesve dhe të punonjësve të zgjedhur dhe të emëruar në Urdhrin e Farmacistëve, në masën 4 700 000 lekë;

b) shpenzime operative për të siguruar funksionimin e institucionit, në masën 1 700 000 lekë;

c) shpenzime për investime kapitale për pajisje zyre dhe një automjet, në masën 3 600 000 lekë;

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Financave dhe presidenti i Urdhrit të Farmacistëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano